



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 50 datë 14.05.2020

**“PËR  
MIRATIMIN E SHEMBJES SË GODINËS TË “TEATRIT KOMBËTAR”, PASURI NË  
PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, BAZUAR NË AKT-EKSPERTIZËN E HARTUAR  
NGA INSTITUTI NDËRTIMIT “MBI VLERËSIMIN E GODINËS SË TEATRIT  
KOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 25, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, të ndryshuar, Vendimit nr.377, datë 8.05.2020, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”, Vendimit nr.894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të Territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”, Vendimin 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, shkresës me nr. 1026/1 prot, datë 13.05.2020 të Institutit të Ndërtimit “Mbi vlerësimin e godinës së Teatrit Kombëtar”, Memos nr. 15121/2, datë 13.05.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Njësi Administrative dhe Emergjencave Civile drejtuar Bashkisë Tiranë, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e shembjes së godinave të “Teatrit Kombëtar”, ndodhur në pasurinë me numër 1/241, zona kadastrale 8150, në pronësi të Bashkisë Tiranë, bazuar në akt- kspertizën nr. 1026/1 prot, datë 13.05.2020 e hartuar nga Instituti Ndërtimit “Mbi vlerësimin e godinës së Teatrit Kombëtar”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Në zbatim të vendimit nr.377, datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave, Bashkia Tiranë në pasurinë nr. 1/241, zona kadastrale 8150 të marrë të gjithë masat e nevojshme për nisjen dhe ndjekjen e procedurës së ndërtimit të godinës bashkëkohore dhe me standarde të Teatrit Kombëtar.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për planifikimin e territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe shembjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objekteve.
5. Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të marrin masat përkatëse për përditësimin e inventarit financiar, listës dhe dokumentacionit të pronave të paluajtshme të Bashkisë Tiranë, sipas parashikimeve të legjislacionit

në fuqi që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme, si dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin.

6. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për prishjen e objektit Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

7. Për ushtrimin e përgjegjësiave dhe detyrave të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të kërkojë asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

8. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

9. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet menjëherë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

10. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI

TONI GOGU

